



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Nr. 104/02-13367/25
08.07.2025

PROCESVERBAL I DËGJIMIT PUBLIK-Me qytetarë Puna e Kryetarit Ilazi të arriturat dhe sfidat për gjashtëmujorin e parë e vitit 2025

Data: 27.06.2025

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Ora 14:00

Me ftesë të Kryetarit të Komunës Besim Ilazi, është mbajtur takimi i parë publik për punën dhe arritjet komunale për gjashtë mujorin e parë për vitin 2025. Takimin e hapi Kryetari i Komunës Besim Ilazi, i cili përshëndeti dhe falënderoi të pranishmit në takim.

Në fjalën e tij Nënkyetari i Komunës Sabedin Vishi prezantoi para të pranishmëve në takim punët dhe aktivitetet komunale në shumë sektor. Nënkyetari Vishi tha se investime janë bërë në rrugë, trotuare, kanalizime e ujësjellës, në sektorin e arsimit janë bërë investime në renovim të shkollave, salla të edukatës fizike, subvencione në bursa e transport të nxënësve, kurse investime tjera janë bërë edhe për turizëm e zhvillim ekonomik duke ndarë subvencione për biznese, e investime poashtu janë bërë edhe në bujqësi duke u shumëfishuar subvencionet në bujqësi e rregullim të infrastrukturës për veprimtarinë bujqësore si dhe investime në shëndetësi, kulturë, Rini e Sport. Të pranishmit në debat kërkuan mirëmbajtje të projekteve që po realizohen si dhe kualitet në punime, investime në rrugë e kanalizime.

Të pranishmit parashtruan kërkesat e tyre specifike:

Nexhmedin Lika: Të rregullohet rrethoja e objektit shkollor në këtë fshat

Azem Koraqi: Rregullimi i i një korite të re të kanalizimit, ky projekt është larguar dhe është zëvendësuar me një projekt tjetër. Poashtu janë disa përrsoka që duhet të pastrohen.

Kadri Dardhishta- Rregullim të rrugëve “ Emin Duraku” në Llanishtë, dhe rregullim të kanalizimit të rruga “ Azem Vokshi” dhe të rregullohet edhe rruga në tërësi.

Hasip Salihu_ Të rregullohet rruga Bajnicë- Semajë si dhe të pastrohen përroskat sepse po ndotin ujësjellësin.

Naser Murseli- Lagjja Leka të lidhet te Mulliri deri te rruga Dallosh, vetëm të bëhet zgjerimi i rrugës.

Nënkryetari Sabedin Vishi: Të gjitha kërkesat janë të arsyeshme dhe të nevojshme për banorët e këtyre lokaliteteve, andaj do të shiqohen të gjitha mundësitë që përmes projekteve të ndryshme, si rregullimi i rrugëve lokale e urbane, rregullimi i kanalizimeve, të intervenohet në këto projekte.

Takimi përfundoi në ora 15:00

Procesmbajtëse

Fatlume Guri Selimi

